

SHPALLJE ANKANDI

BASHKIA KORÇË **NJOFTIM ANKANDI**

1. Autoriteti shitës: Bashkia Korçë, Lagjia 12. Blv. "Shen Gjergji" nr 12. nr tel 082243353.
2. Data e zhvillimit të ankandit 19. 11. 2019, ora 11.00.
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit

Ankandi do të zhvillohet me procedurë të hapur.

4. Objekti i Shitjes: Dhënien me qira të fondit pyjor me sipërfaqe prej 2.13 ha në pronësi të Bashkisë Korçë për veprimtari turistike dhe mjedise sportive (Pista e Skive Dardhë).
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes;

Dhënien me qira të fondit pyjor me sipërfaqe prej 2.13 ha në pronësi të Bashkisë Korçë për veprimtari turistike dhe mjedise sportive (Pista e Skive Dardhë) të detajuar në tabelën e më poshtme:

Ekonomia pyjore	Ngastra	Përdorimi i territorit	Sip. ha	Sipërfaqja me Qira ha	Tarifa dhënie në përdorim lek/ha/vit	TOTALI lekë
					6 deri 10 vjet	
1	2	3	4	5	6	7
Zëmlak-Qarr	117a	Pyll, Cungishte	30	2.13	75,000	159,750
TOTAL				2.13		159,750

6. Vlera fillestare është 159 750 lekë (Njëqind e pesëdhjet e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjet).
7. Vendi i zhvillimit te ankandit: (Adresa:) Bashkia Korçë, Salla e mbledhjeve, kati i II.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:
19.11.2019 ora 11:00, ofertat duhet të jenë të hartuara në gjuhën shqipe.
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:
Dokumentet e ankandit mund te trerhiqen prane autoritetit shites
Dokumente me pagesë:

Po X Jo ☐

Nëse Po

Monedha Lek Çmimi 1000

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbal/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

10. Kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet e kërkuara

Në përputhje me LAP, Kandidatet blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre adresën e subjektit, telefon, email dhe faks;
- c) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- d) çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- e) ne rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit te ankandit
- f) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- g) lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
- h) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- i) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë, ne lidhje me objektin e ankandit;
- j) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime ndaj Bashkisë Korçë.

Kriteret qe do te vleresohen dhe sistemi i pikezimit;

- a) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar; 20 pikë
- b) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen; 15 pikë
- c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme; 25 pikë
- d) nivelin e punësimit në veprimtari; 5 pikë
- e) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit; 35 pikë

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.